Në bazë të neneve 22 dhe 23 të Ligjit për Marrëdhënie Pune tekst i spastruar i Publikuar në (''Gazetën Zyrtare të RM-së'' numër 167/2015 dhe ndryshimin dhe plotësimin e LMP të RM-së 27/2016, 120/2018 dhe ''Gazeta zyrtare e RMV-së'' numër 110/2019, 267/2020, 151/21, 288/21, 111/23, 39/25 dhe 74/25), pastaj në përputhje me dispozitat e Rregullorës për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të HRMV Transport ShA - Shkup (Botim i dytë i ndryshuar dhe plotësuar) numër 902/1-11 të datës 11.05.2021...311/1-1 datë 13.02.2024...812/1-1 datë 23.05.2025, neni 3 paragrafi 1, neni 4, neni 5, neni 6 dhe neni 26 paragrafi 1 i Marrëveshjes Kolektive të HRMV Transport ShA – Shkup, Njoftimi i Ministrisë së Financave nr. 19-5069/2 datë 21.05.2025 dhe Vendimi numër 851/1 të datës 02.06.2025, HRMV Transport SHA - Shkup, shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e krijimit të marrëdhënies së punës me 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë për të kryer punë me kohë të caktuar në HRMV Transport SHA - Shkup.

Kandidatët, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë kushtet e posaçme të përcaktuara në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në HRMV Transport ShA - Shkup për plotësimin e vendeve të lira të punës në vijim:

1. 1 (një) realizues në vendin e punës 2.6.6. Administrator – daktilograf, në Njësinë e burimeve njerëzore, në Njësinë e burimeve njerëzore, arsim fillor KMK/KK, shkalla II/III, drejtimi i përgjithshëm, pa përvojë pune, për të cilin vend pune paga është 24.709,00 denarë.

2. 1 (një) realizues në vendin e punës 2.10.5. Magaziner (ekonomist), në Seksionin e çështjeve të përgjithshme, në Njësinë e Funksioneve korporative, arsim i mesëm KK/ SHSSH, shkalla e III/IV, drejtimi i përgjithshëm, pa përvojë pune, për të cilin vend pune paga është 24.953,00 denarë.

3. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.13.9. Ndihmës makinist - praktikant, në Njësinë Lisiçe në NJP Tërheqje në Filialin e tërheqjes së trenave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi Makinist, të plotësojë kushtet e nevojshme shëndetësore për një punëtor hekurudhor të përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e formës së kërkesës për përcaktimin e aftësisë fizike dhe psikologjike, mënyrën e përcaktimit të tyre, kontrollet dhe afatet për ekzaminim të rregullt dhe të jashtëzakonshëm shëndetësor të makinistit (Gazeta Zyrtare e RM nr. 136/13), pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 23.536,00 denarë.

4. 2 (dy) realizues në vendin e punës 7.15.5. Ndihmës makinist - praktikant, në Njësinë Gjevgjeli në NJP Tërheqje në Filialin e tërheqjes së trenave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi Makinist, të plotësojë kushtet e nevojshme shëndetësore për një punëtor hekurudhor të përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e formës së kërkesës për përcaktimin e aftësisë fizike dhe psikologjike, mënyrën e përcaktimit të tyre, kontrollet dhe afatet për ekzaminim të rregullt dhe të

jashtëzakonshëm shëndetësor të makinistit (Gazeta Zyrtare e RM nr. 136/13), pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 23.536,00 denarë.

5. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.32.4. Elektomekanik grupi i II-të - praktikant, në Njësinë e lokomotivave elektrike në NJP Mirëmbajtja në Filialin e tërheqjes së trenave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi elektrik, pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 21.776,00 denarë.

6. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.34.4. Elektromekanik grupi i II-të - praktikant, në Njësinë për pajisjet e sigurisë dhe montimet elektrike, në NJP Mirëmbajtja në Filialin e tërheqjes së trenave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi elektrik, pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 21.776,00 denarë.

7. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.10.4. Lëshues materialesh, në Njësinë e Magazinimit, në NJP Përgatitja Teknike Komerciale - PTK në Filialin e Tërheqjes së Trenave, arsim fillor KMK/KK, shkalla II/III, drejtimi i përgjithshëm, pa përvojë pune, për të cilin vend pune paga e praktikantit është 24.709,00 denarë.

8. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.24.3. Saldues - praktikant, në Seksionin e përpunimit të lehtë në NJësinë e përpunimit mekank, në NJP Mirëmbajtja, në filialin e tërheqjes së trenave, arsimi fillor KK/SHSSH, shkalla e III/IV, drejtimi mekanik/ i përgjithshëm, me çertifikatë saldimi, pa përvojë pune, për të cilin pozicion paga e praktikantit është 22.949. 00 denarë.

9. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.43.9. Mekanik praktikant, në Njësinë e mirëmbajtjes së vagonëvë të udhëtarëve, në NJP veprimtaria teknike e atomjeteve TKD në Filialin e Tërheqjes së trenave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi mekanik, pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 22.558,00 denarë.

10. 1 (një) realizues në vendin e punës 7.35.3. Mekanik praktikant, në Njësinë për lyerje dhe mbulim (shtresim) në NJP Mirëmbajtja në Filialin e tërheqjes së trenave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi mekanik, pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 23.927,00 denarë.

11. 3 (tre) realizues në vendin e punës 3.10.10. Tranzitor - operator terminali - praktikant, në Njësinë Gjevgjeli në NJP Mirëmbajtja në filialin e transportit të mallrave, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi trafik/i përgjithshëm, pa përvojë pune, për cilin vend pune paga e praktikantit është 22.753,00 denarë.

12. 1 (një) realizues në vendin e punës 1.10.A.6. Punëtor sigurimi, në Seksionin e mbrojtjes dhe menaxhimit të krizave në Njësinë e Sigurisë dhe shëndetit në punë, mbrojtjes dhe menaxhimit me kriza, me përgaditje profesionale arsim të mesëm KK/SHSSH, shkalla III/IV, drejtimi i përgjithshëm, me licencë për sigurimin e pronës dhe personave, pa përvojë pune, për cilin vend pune paga është 24.709,00 denarë.

Kandidatët në fletëparaqitjen me shkrim përcaktojnë vetëm një vend pune për të cilin apolikojnë dhe për këtë arsye është e nevojshme të dorëzohen dokumentet në varësi të kushteve të përmendura për vendin konkret të punës për të cilin aplikojnë, si më poshtë:

- Formular i plotësuar me shkrim - fletëparaqitje për punësim të cilin e nënshkruan dora vetë e Kandidatit. (Shënim i rëndësishëm: Me një formular të plotësuar dhe të nënshkruar - Fletëparaqitje për punësim, kandidati mund të aplikojë vetëm për një vend pune nga konkursi).
  Formulari me shkrim - Fletëparaqitje për punësim është e publikuar në uebfaqen e HRMV Transport SHA – Shkup e cila është: www.mzt.mk
- Biografi e shkurtër (CV);
- Dëshmi për arsimimin e përfunduar (në kopje të noterizuar ose origjinal);
- Çertifikata e shtetësisë (kopje);
- Fotokopje të letërnjoftimit të vlefshëm të Kandidatit;
- Për vendin e punës numër 8 Saldues - praktikant, çertifikatë saldimi (në kopje të noterizuar ose origjinal)
- Për vendin e punës numër 12 - Punëtor sigurimi, licencë për sigurimin e pronës dhe personave, (në kopje të noterizuar ose origjinal)

Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit dhe dokumentet e përmendura më lartë me fletëparaqitje me shkrim – formular mundet t'i dorëzojnë në hapësirat e HRMV Transport SHA-Shkup në Bulevardin Brigada e tretë maqedonase, nr.66 Shkup më datë 04.06.2025, 05.06.2025, 09.06.2025, 10.06.2025 dhe 11.06.2025 prej ora 08:00 deri më 14:00.

Dokumentet e kërkuara mund të dorëzohen edhe me postë të rekomanduar në adresën e HRMV Transport ShA - Shkup, në bulevardin e 3-të Brigada maqedonase numër 66, Shkup, me shënim për shpalljen publike për punësim.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, i njoftojmë të gjithë kandidatët e interesuar se dorëzimi i aplikacionit dhe dokumenteve të nevojshme nuk lejohet të bëhet në mënyrë elektronike dhe të njëjtat nuk do të merren në shqyrtim.

Kandidatët janë të detyruar të plotësojnë formularin me shkrim – FLETËPARAQITJE PËR PUNËSIM, i publikuar në faqen e internetit të HRMV Transport SHA - Shkup në mënyrë të plotë, të saktë dhe me të dhëna të sakta.

Parashtrimet e vonuara, si dhe fletëparaqitjet me shkrim jo të kompletuara, nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Përzgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të bëhet brenda 45/90/120 ditëve pas skadimit të afatit të aplikimit, në varësi të numrit të kandidatëve të paraqitur.

Marrëdhënia e punës bazohet në periudhë të caktuar kohore për periudhën deri më 31.12.2025.

Java e punës zgjat 5 ditë pune, koha e plotë e punës është 40 orë në javë. Koha e punës për vendet e punës nën nr. 1, 2, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 e 8 është 8 (tetë) orë pune në ditë, fillimi dhe mbarimi i orëve të përditshme të punës është nga 7.30 deri në 15.30, me të drejtë pushimi gjatë punës së përditshme që zgjat 30 minuta, në periudhën nga 10.30 në 11.00. ora.

Për vendet e punës nën nr. 3, 4, 11 dhe 12 orët e punës do të përcaktohen me turn.

Për vendet e punës nën nr. 3 dhe 4 para lidhjes të Kontratës së Punës, kandidati do të referohet për një kontrollim mjekësor dhe lidhja e Kontratës do të varet nga rezultatet e së njëjtës.

Të gjithë formularët do të përpunohen me besueshmëri maksimale.

Për zgjedhjen, kandidatët e paraqitur do të njoftohen në afat brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e lidhjes së kontratës së punës me kandidatin e përzgjedhr.

Numër: 853/1
02.06.2025
Shkup **HRMV Transport SHA – Shkup**